



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:284375  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05706048

**C-IV-14-0704**  
*Ankuesi/Paditësi*

M H fshati P, Komuna e Suharekës, të cilin e përfaqëson avokat R G nga Suhareka

*Kundër*

*Palët kundërshtare/Të paditurat*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) ( NSH “IGK Ballkan” në likuidim), Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55, Prishtinë, dhe**

**NSH- IGK “Ballkan”, Suharekë, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP), Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55, Prishtinë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 20 maj 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- 1. Refuzohet kërkesë padia e ankuesit-paditësit me të cilën kërkohet kompensimi i të ardhurave personale në shumë prej 5,327.56 (pesë tre dy shtatë pesë gjashtë) Euro, e drejtë kjo e bazuar sipas Vendimit të NSH nr. 287/1 datë 20 gusht 2001 si dhe ti njihet e drejta në përvojën e punës për periudhën nga data 8 gusht 1990 gjer 1 korrik 1999.**
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 18 shkurt 2014, ankuesi-paditësi pranë DHPGJS, parashtroj një kërkesë, padi, me të cilën kërkon siç thuhet, që të obligohet AKP-Autoriteti i Likuidimit, që nga fondi i krijuar nga privatizimi dhe likuidimi, i NSH “IGK Ballkan”, ti kompensoj të ardhurat personale në shumë prej 5,327.56 (pesë tre dy shtatë pesë gjashtë) Euro, e drejtë kjo e bazuar sipas Vendimit të NSH si dhe ti njihet e drejta në përvojën e punës për periudhën nga data 8 gusht 1990 gjer 1 korrik 1999.

Ankuesi-paditësi, kërkoj kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Ankuesi-paditësi, fillimisht pohon se NSH me Vendimin e saj nr. 287/1 datë 20 gusht 2001, të gjithë punëtorëve të NSH përfshirë edhe ankuesi, ju njeh të drejtën në kompensim në shumën e kërkuar dhe periudhë të kërkuar e po ashtu edhe ju njeh të drejtën në përvojën e tyre të punës

nga data 8 gusht 1990 gjer me 1 korrik 1999, e të cilit ishin larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme.

Ankuesi-paditësi tutje pohon se me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suherekë, C.nr. 176/05 datë 24 qershor 2006, i është njohur e drejta në kompensim në shumë prej 5,327.56 (pesë tre dy shtatë pesë gjashtë) Euro, për periudhën e kërkuar, si dhe përvoja e punës për këtë periudhë.

Ankuesi-paditësi gjithashtu pohon se për dallim prej tij, punëtorëve tjerë nga ana e Autoritetit të Likuidimit, me Vendimin PRZ014-00042/0516 datë 6 dhjetor 2013 ju është njohur e drejta në kompensim.

Ankuesi-paditësi në vijim thekson se ai dhe disa punëtorë tjerë nuk ishin të përfshirë në padinë e datës 23 qershor 2005 dhe ende nuk i është njohur e drejta në kompensim edhe përkundër faktit se kishte të njëjtin status si punëtorët e tjerë.

Andaj nga gjitha arsyet i propozoj gjykatës që të obligohet AKP-Autoriteti i Likuidimit, që nga fondi i krijuar nga privatizimi dhe likuidimi, i NSH "IGK Ballkan", ti kompensoj të ardhurat personale në shumë prej 5,327.56 (pesë tre dy shtatë pesë gjashtë) Euro, e drejtë kjo e bazuar sipas Vendimit të NSH si dhe ti njihet e drejta në përvojën e punës për periudhën nga data 8 gusht 1990 gjer 1 korrik 1999.

Kërkesë padisë i është bashkangjitur:

- Kopja e shkresës së AKP – AL, me të cilën ankuesi-paditësi është informuar se kërkesa e tij kreditore e parashtruar pranë AL është e pas-afatshme, sepse është dorëzuar me 9 dhjetor 2013 gjersa afati mbi parashtrimin e kërkesës ishte gjer me datën 24 maj 2008, dhe
- Kopje e faqes së parë së librezës së punës, por jo edhe vazhdimi i saj ku do të shihej marrëdhënia e punës – përvoja pranë NSH.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 13 tetor 2021 parashtror përgjigjen.

AKP kundërshtoj kërkesën –padinë duke e konsideruar si të pabazuar. AKP pohon se ankuesi-paditësi ka parashtruar një kërkesë kreditore pranë Zyrës Regjionale në Prizren me 9 dhjetor 2013 e që ishte jashtë afatit mbi parashtrimin e kërkesave me 24 maj 2008. Andaj pasi që kërkesa është e jashtë afatit, AKP, u propozua që kërkesa – padia të refuzohet si e pabazuar.

Përgjigjes i është bashkangjitur kopja e Vendimit për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Përgjigja e AKP ju dorëzua ankuesit me 2 nëntor 2021.

Nuk u parashtrua përgjigje, nga ankuesit.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatë, përfaqësuesi i ankuesit-paditësit me 21 janar 2022 parashtror kopjen e autorizimit për përfaqësim.

### **Arsyetimi ligjor:**

Kërkesë-padia konsiderohet si e parashkruar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

### Parashkrimi i kërkesës

Ankuesi-paditësi kërkon njohjen e së drejtës së tij mbi të ardhurat personale në shumë prej 5,327.56 (pesë tre dy shtatë pesë gjashtë) Euro, e drejtë kjo e bazuar sipas Vendimit të NSH 287/1 datë 20 gusht 2001, si dhe ti njihet e drejta në përvojën e punës për periudhën nga data 8 gusht 1990 gjer 1 korrik 1999.

Ankuesi-paditësi pretendon se pasi që nuk ishte i përfshirë në padinë e datës 23 qershor 2005 dhe ende nuk i është njohur e drejta në kompensim edhe përkundër faktit se kishte të njëjtin status si punëtorët e tjerë atëherë me padi të veçantë pranë DHPGJS, padi kjo e parashtruar me 18 prill 2014, ti njihet e drejta e kërkuar.

Në pajtim me 87 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), gjykata një kërkesë të këtillë e konsideron si të parashtruar. Sipas këtij neni, thuhet, citat: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”.

Ky parashkrim rrjedh nga fakti se kërkesa e ankuesit rrjedh nga Vendimi i NSH 20 gusht 2001 gjersa ankesa – padia pranë DHPGJS është parashtruar me 18 prill 2014, apo pas 12 viteve e 8 muajsh.

Nga gjitha arsyet gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### Obiter dictum ( ndër të tjerash)

Edhe pse kjo nuk është pjesë e këtij Aktgjykimi, sipas kopjes së shkresës së AKP – Autoritetit të Likuidimit, ankuesi-paditësi është informuar se kërkesa e tij kreditore e parashtruar pranë AL është e pas-afatshme, sepse është dorëzuar me 9 dhjetor 2013 gjersa afati mbi parashtrimin e kërkesës ishte gjer me datën 24 maj 2008.

Edhe pse ankuesi-paditësi nuk e ka atakuar njoftimin – vendimin e cekur si më lartë, shihet se edhe kërkesa mbi kompensimin e pagave është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor, e me të cilën kërkesat e punëtorëve mbi pagat do të shqyrtoheshin nga e Autoritetit të Likuidimit, i cili autoritet gëzon të drejtën ligjore sipas Shtojcës së Ligjit të AKP ti shqyrtoj kërkesat e tilla ( neni 40).

### Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

## **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar